

UDHËZIM
Nr. 27, datë 1.9.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 6.8.2014 “PËR ZHVILLIMIN E KONKURSEVE TË PRANIMIT DHE TARIFËN E REGJISTRIMIT PËR KONKURRIM NË DISA PROGRAME STUDIMI TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2014 - 2015”

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 33 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, tëndryshuar, vendimi nr.517, datë 1.8.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimi në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2014 - 2015”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e maturës shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 13.2 e udhëzimit nr.20, datë 6.8.2014, të ndryshojë si më poshtë:
“13.2 Universiteti i Sporteve të Tiranës ne periudhën:
1 shtator – 5 shtator 2014”.

2.Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe institucionet publike përkatëse të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla